



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë
01 Nr. _____ /2022
Dt. 28.09.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 dhe 17 të Ligjit 03/L-040, Për Vetëqeverisje Lokale, nenin 21 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 24 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenin 14 pika b të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me dt.28.09.2022, pas diskutimeve lidhur me pikën e 12 të rendit të ditës: Propozim Vendimi i Kryetarit të komunës për dhënien në shfrytëzim të parcelës nr.P.70705028-04346-4 në Zonën Kadastrale Gjakovë –Jashtë Qytet, për ndërtimin e objektit të Zyrës Regjionale të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në Gjakove, e miratoi këtë :

V e n d i m

1. Parcela me numër P.70705028-04346-4 në Zonën Kadastrale Gjakovë –Jashtë Qytet, në Pronësi të Komunës së Gjakovës, ipet në shfrytëzim afatgjatë Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, për ndërtimin e objektit të Zyrës Regjionale të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) në Gjakovë.
2. Qëllimi i dhënës në shfrytëzim të Parcelës është ndërtimi i objektit të Zyrës Regjionale të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) në Gjakovë, sipas kërkesës së Agjencisë .
3. Obligohen organet e Administratës të Komunës së Gjakovës si dhe të Agjencionit së Ushqimit dhe të Veterinarisë (AUV) që ti ndjekin procedurat administrative konform dokumentacionit të planifikimit si dhe konformë dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

5.Vendimi iu dërgohet:

- z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë .
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit.

